

VENDIM
Nr.565, datë 7.5.2008

**PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2008, MIRATUAR PËR
SHËRBIMIN INFORMATIV TË SHTETIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 21 e 27 të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998 “Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 11 të ligjit nr.9863, datë 26.11.1007 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2008”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shërbimit Informativ të Shtetit, në buxhetin e miratuar për vitin 2008, zëri “231 – Shpenzime kapitale të trupëzuar”, t’i shtohet fondi prej 6 000 000 (gjashtë milionë) lekësh.
2. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.
3. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Shërbimi Informativ i Shtetit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha